BANKA E BASHKUAR E SHQIPERISE

RAPORTE FINANCIARE PERIODIKE

(Sipas kerkesave te rregullores Nr.60, date 29.08.2008 te Bankes se Shqiperise, ndryshuar me Vendim Nr.25 dt 1.04.2015)

PERMBAJTJA:

1. Informacion i pergjithshem
2. Shenime per pasqyrat financiare dhe politikat kontabel
3. Bilanci kontabel dhe zerat jashte bilancit te permbledhura
4. Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve
5. Tregues te rentabilitetit te bankes
6. Struktura e Kapitalit rregullator
7. Mjaftueshmeria e Kapitalit
8. Klasifikimi i portofolit te financimeve sipas sektoreve
9. Klasifikimi i portofolit te financimeve sipas tipit te industrise
10. Klasifikim I portofolit te financimeve sipas shperndarjes gjeografike
11. Klasifikimi sipas maturitetit te mbetur
12. Fondet per provigjone dhe levizjet gjate periudhes
13. Rreziku I financimse sipas metodes standarte
14. Fondet per provigjione dhe levizjet gjate periudhes
15. Rreziku i Likuiditetit
16. Ekspozimi ndaj risqeve dhe Vleresimi I tyre

Hyrje

1. Informacion i pergjithshem

Banka e Bashkuar e Shqipërisë (referuar më poshtë si “Banka” ose “UBA”) është krijuar në Shqipëri për të zhvilluar veprimtari bankare në përputhje me legjislacionin Shqiptar. Bazuar ne nenet e Statutit te saj, Banka ndjek Parimet Sharia. Aktivitetet e Bankës përfshijnë veprimtarinë si administruese, mbi bazën e mirëbesimit, të fondeve të investuara në përputhje me parimet dhe ligjet Islamike. Banka është subjekt i Ligjit Nr. 9662 “Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë”, të datës 18 dhjetor 2006 dhe nën mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë. Në 5 nëntor 1992, Banka mori aprovimin nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare. Procedurat e regjistrimit përfunduan në 1 korrik 1994, data e themelimit. Në 11 janar 1999, në përputhje me Vendimin Nr.165, të datës 11 dhjetor 1998 të Bankës së Shqipërisë, Banka mori licensën “Për vazhdimin e aktivitetit bankar në Republikën e Shqipërisë”, në përputhje me Ligjin Nr. 8365, te datës 2 korrik 1998,”Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Aksioneret kryesore jane :	
Banka Islamike per Zhvillim, Jeddah	**77.7%**
Eurosig sha	**9%**
Ithmaar Bank B.S.C.	**4.63%**
Dallah Albaraka Holding Co	**2.32%**
Investitorë të tjerë - Arabia Saudite	**6.35%**

Kapitali i rregjistuar:	1,762,717 mije Leke,
Numri i aksioneve:	547,421
Aksione të zakonshme me vlerë nominale secili:	3,220.04 Leke

Qendra e Bankës është vendosur në Tiranë. Aktualisht Banka ka një shpërndarje të aktivitetit në 4 qytetet Tirane, Shkoder, Fier dhe Durres si dhe ka dy agjenci të vendosura në Tiranë. Më 30 Shtator 2019 numri i të punësuarve është 76 (2018: 77).

Banka e Bashkuar e Shqipërisë ushtron aktivitet bankar në Republikën e Shqipërisë bazuar ne licencen Nr.03/1 akorduar nga Banka e Shqipërisë, duke ofuar sherbimet/produktet si vijon:

- Të gjitha format e financimeve, duke përfshirë edhe financimin konsumatore dhe financimin hipotekore;
- Qiranë financiare;
- Të gjiha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave, duke perfshirë kartat e kreditit dhe te debitit, ceqet e udhetarit,ceqet bankare dhe kartat e pagesës;
- Ofrimin e garancive;
- Tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një kembim valutor, në një treg të vetorganizuar(OTC) ose ndryshe si më poshtë:
  - i) Instrumente të tregut të parasë (ceqe,dëftesa,certifikata të depozitave etj),
  - ii) Këmbim valutor,
  - iii) Instrumenta te kembimeve valutore dhe instrumente për vlerësimin e normës së fitimit, duke përfshirë këtu produkte te tilla, si marreveshje swap dhe marreveshje që përcaktojnë vleren e fitimit në të ardhmen.
- Ofrimin e sherbimit te kasave te sigurimit;
- Sherbimet keshilluese, ndermjetes dhe sherbime te tjera ndihmese per te gjitha vemprimtarite e listuara ne pikat 2 deri 6 si me siper.

Struktura, kualifikimet dhe pergjegjesite e Organeve Drejtuese

❖ Keshilli Drejtues

Gokhan Gozkurt	- Kryetar
Amer Bukvic	- Nenkryetar
Emina Sisic	- Anetar
Mohamad Al Midani	- Anetar
Areef Suleman	- Anetar

- **Kualifikimet:**

Gokhan K. BOZKURT (Kryetar) I diplomuar në Ekonomi në Universitetin Bilkent në Ankara – Turqi; Fituar titullin Master of Arts në Universitetin Johns Hopkins – Baltimore, MD USA. Eksperiencë e gjatë në sektorin bankar dhe atë te komunikacionit, drejtues i departamenteve të ndryshme deri në Drejtor i Përgjithshëm; anëtar i Këshillit Drejtues të institucioneve të rëndësishme.

Amer BUKVIC (Zv. Kryetar) Ka përfunduar Universitetin Ndërkombetar Islamik të Malajzise, mban titullin BHSC ne Shkencat Politike; Master i Arteve në Marrëdhënie Ndërkombetarë, Universiteti Ndërkombetar i Japonisë. Z. Bukvic ka eksperience të gjate akademike. Aktualisht është Drejtor i Përgjithshëm i Bosnia Bank International (BBI), ndër më të mirat në Federatën e Bosnje Hercegovinës.

Emina SISIC (Anetar) Ka përfunduar studime Bachelor në Ekonomi në Universitetin e Sarajevës. Gëzon titullin Ekspert Kontabël i Çertifikuar nga Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Federatës së Bosnje Hercegovines. Znj. Sisic, gëzon titullin Master në Drejtim nga Universiteti i Sarajevës si dhe Master në Administrim Biznesi Ndërkombëtar nga Griffith College, Dublin. Eksperiencë e gjatë në sektorin bankar duke mbuluar pozicione të ndryshme drejtuese.

*Mohamad Al MIDANI (Anetar)*I diplomuar në Kontabilitet në Universitetin e Konkordias, ka shërbyer për një periudhë 18-vjecare prane Bankës Islamike për Zhvillim, prej të cilave 10 vjet si Drejtor I Departamentit të Investimeve, Equity Division, duke drejtuar një ekip prej 10 profesionistësh dhe një portofol investimesh 1.3 miliardë dollarë amerikanë. Gjatë gjithë periudhes së punës në B.I.Zh, midis shumë funksioneve të tjera, ai ka luajtur rol të rëndësishëm edhe në ushtrimin e kontrollit mbi investimet dhe vendimarrjen e përshtatshme sipasit stadit dhe ecurisë per secilin investim. Gjithashtu, përgjatë tre viteve të fundit ai ka përfaqësuar B.I.Zh. në Këshillin Drejtues të Kuwait Turk Participation Bank. Në të kaluarën ai ka përfaqësuar B.I.Zh. në këshillin drejtues të disa kompanive të tjera ku B.I.Zh. ka investime.

Areef SULEMAN (Anetar) I diplomuar në Udhëheqje Biznesi në Universitetin e Afrikës së Jugut, mban titullin PHD në Ekonomi. Ju bashkua B.I.Zh në Shkurt te vitit 2007. Si pjesë e punes së tij ai është përgjegjës për hartimin e programeve dhe nismave me efekt të lartë të IDB të cilat promovojne rritje gjithëpërfshiresë dhe qëndrueshmëri. Në 2013 u emërua nga IDB në Këshillin Drejtues të IBBL, e për shkak të performancës së tij, së fundmi ai u emërua gjithashtu për të kryer funksionin e Presidentit të degës së IBBL,Islamic Bank Securities Limited(IBSL). Aktualisht është Drejtor I Kërkimeve Ekonomike dhe Studimeve Institucionale pranë Bankës Islamike për Zhvillim.

- **Përgjegjësitë**:

1. Këshilli drejtues, në funksion të drejtimit të bankës në përputhje me objektivat, strategjitë dhe politikat e miratuara, si dhe në fitimin më të mirë të saj, shqyrton dhe vlerëson:
   a. zhvillimin dhe mbajtjen e një niveli të mjaftueshëm të ekspertizës profesionale në përputhje me rritjen dhe kompleksitetin e veprimtarisë së bankës;
   b. sigurinë dhe qëndrueshmërinë financiare të bankës;
   c. njohjen e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
   d. parandalimin dhe shmangien e konflikteve të mundshme të fitimit në veprimtarinë dhe vendimmarrjen e bankës; si dhe
   e. mbrojtjen e fitimeve të klientëve, investitorëve dhe të publikut në përgjithësi.
2. Miraton dhe kontrollon zbatimin e politikave dhe strategjive te bankes, ne perputhje me planin e biznesit, menaxhimin e rrezikut, buxhetin vjetor;
3. Percakton objektivat afatgjate te bankes dhe monitorimin e realizimit te ketyre objektivave;
4. Monitorimin e efektivitetit te praktikave te drejtimit te bankes dhe kryerjen e ndryshimeve te nevojshme per permiresimin e ketyre praktikave;
5. Krijon komitet, në rast se është e nevojshme, për trajtimin e çështjeve që paraqesin fitim të veçantë për bankën, duke përcaktuar në mënyrë të qartë kohëzgjatjen e mandatit, përbërjen dhe procedurat e tyre të punës;
6. Përcakton kushtet dhe standardet për përzgjedhjen, shpërblimin, vlerësimin dhe largimin e drejtorëve të bankës, si dhe monitorimin e praktikave për zëvendësimin e personelit të bankës;
7. Monitoron dhe trajton konfliktet e mundshme të fitimit të drejtorëve, të anëtarëve të këshillit drejtues dhe të aksionerëve, përfshirë këtu edhe trajtimin e konflikteve të mundshme të fitimit, që mund të rrjedhin nga keqpërdorimi i mjeteve të bankës dhe veprimet me personat e lidhur;
8. Merr masat e nevojshme dhe të mjaftueshme për të siguruar integritetin e sistemeve financiare dhe të kontabilitetit të bankës, duke përfshirë kontrollin e pavarur të bankës dhe duke siguruar ekzistencën e sistemeve të përshtatshme të kontrollit, veçanërisht në lidhje me administrimin e rrezikut, sistemin operacional dhe financiar të bankës, si dhe duke siguruar zbatimin e ligjit dhe praktikave më të mira në fushën bankare;
9. Monitoron dhe mbikëqyr zbatimin e kërkesave ligjore e rregullative dhe të praktikave më të mira në sistemin bankar;
10. Mbikëqyr procesin e dhënies së informacionit dhe komunikimin me publikun.

❖ Komiteti I Kontrollit

Emina Sisic -Kryetar
Albana Ferraj -Anetar
Joana Pano -Anetar

○ Kualifikimet:

Zj.Emina Sisic

Ka përfunduar studime Bachelor ne Ekonomi në Universitetin e Sarajevës. Gëzon titullin Ekspert Kontabël i Çertifikuar nga Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Federatës së Bosnje Hercegovinës. Znj. Sisic, gezon titullin Master ne Drejtim nga Universiteti i Sarajevës si dhe Master në Administrim Biznesi Ndërkombetar nga Griffith College, Dublin. Eksperiencë e gjatë në sektorin bankar duke mbuluar pozicione të ndryshme drejtuese.

Zj. Albana Ferraj

Znj. Ferraj ka përfunduar studimet universitare pranë Fakultetit te Ekonomise – Universiteti i Tiranes (1996). Po pranë ketij fakulteti ajo ka perfunduar, studimet pasuniversitare në programin e perbashkët Master në Administrim Biznes, me Universitetin e Nebraskës SHBA (2003). Gjatë vitit 1997 e në vazhdimësi ajo ofron sherbimet e saj si pedagoge e jashtme e Departamentit te Kontabilitetit prane UT.

Znj. Ferraj, cilesohet si profesioniste me njohuri të thelluara në fushën e kontabilitet financës dhe ka fituar Liçensën Profesionale si Kontabilisti Miratuar dhe Ekspert Kontabël i Regjistruar. Gjate eksperiencës së saj ka përfituar cilësi dhe kualifikime te rëndësishme në fushën e drejtimit financiar, sistemet e kontrollit të brendshëm, kontabilitet kosto e drejtimi, standarte kombetarë e ndërkombetarë të raportimit financiar, kuadri rregullator mbikqyrës së institucioneve financiare etj.

Znj. Joana Pano

Eshte diplomuar në Universitetin e Tiranës, Dega Financë Kontabilitet (2008). Gjithashtu Znj. Pano ka përfunduar studimet dhe ka marre Diplomë Master të Nivelit të Dytë në Kontabilitet po pranë Universitetit të Tiranës (2010). Nga viti 2013 ka fituar titullin Ekspert Kontabël i Autorizuar.

Ka eksperiencë dhe angazhime të ndryshme në fushën e auditimit si dhe në fushën e konsulencave financiare, duke kontribuar në rritjen e vlerave të kompanive ku ka punuar me ane te ekzpertizës së saj profesionale si dhe pergjegjshmërisë dhe etikës qe karakterizon marredhëniet e saj të punës.

- **Pergjegjesite**:

1. Kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e procedurave kontabël dhe të kontrollit të brendshëm të bankës, duke përfshirë edhe procedurat e vendosura nga Banka e Shqipërisë, kontrollon llogaritë bankare dhe regjistrimet përkatëse;
2. Shqyrton raportet e kontrollit të brendshëm dhe monitoron trajtimin e përfundimeve të dala nga këto raporte;
3. Propozon ekspertin kontabël të autorizuar dhe realizon komunikimin ndërmjet tij dhe kontrollit të brendshëm të bankës;
4. Bën vlerësimin e situatës financiare të bankës, bazuar në raportin e ekspertit kontabël të autorizuar;
5. Kontrollon përputhshmërinë e veprimtarisë së bankës me aktet ligjore dhe nënligjore dhe njofton për përfundimet këshillin drejtues të bankës;
6. I jep mendim këshillit drejtues të bankës për të gjitha problemet që i kërkohen prej këtij të fundit;
7. Miraton raportet dhe deklaratat financiare të përgatitura nga banka, me qëllim publikimin e tyre.

❖ Drejtoria

Muhamed Prlja - CEO

- **Kualifikimet:**

Eshtë diplomuar në vitin 1999 ne profilin Administrim Biznesi në Universitetin Ndërkombëtar te Malajzisë. Me pas ka ndjekur studimet Master degree në Islamic Finance në Fakultetin Ekonomik – Universiteti i Sarajevës. Pjesmarrës në trajnime të avancuara në institucione të rëndesishme bankare dhe financiare. Pas një experience te sukseshme 15 vjecare në pozicione drejtuese në institucione të rëndësishme bankare dhe financiare, në Mars te vitit 2015 Z. Prlja u emërua Drejtor i Përgjithshëm i Bankës së Bashkuar të Shqipërisë.

- **Pergjegjesite**:

1. Drejtoria organizon dhe drejton në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë e bankës.
2. Drejtoria përcakton dhe mund të delegojë detyrat tek personeli, si dhe mbikëqyr ushtrimin e përgjegjësive të deleguara, në përputhje me politikat dhe procedurat e miratuara.
3. Drejtoria ndërmerr masat e nevojshme për të monitoruar dhe administruar të gjitha rreziqet ndaj të cilave është e ekspozuar Banka, në përputhje me strategjitë e miratuara.
4. Drejtoria zbaton politikat dhe strategjitë e miratuara, si dhe siguron që proceset e administrimit të rrezikut të jenë në përshtatje të vazhdueshme me profilin e rrezikut të bankës dhe planin e biznesit të miratuar.


Asambleja e Pergjithshme
Keshilltari I Sheriatit
Keshilli Drejtues
Komiteti I Kontrollit
Departamenti I Kontrollit te Brendshem
Komiteti i Shpërblimeve
Komiteti i RrezikutALCO)
Komiteti I Financimeve
Komiteti I Burimeve Njerezor
Komiteti I Rikuperimit te Financimeve
Komiteti Perputhshmerise
Komiteti I TIK
Komiteti BCM
Drejtori i Pergjithshem
Grupi I Biznesit
Grupi Mbeshtetes
Departamenti I Individeve
Departamenti I Korporateve
Departamenti Thesarit dhe Institucioneve Financiare
Departamenti Rrezikut
Departamenti Juridik
Depart. Burimeve Njerezore & Administrates
Dept.Finances & Planifikimt Strategjik
Departamenti Operacional
Departamenti TIK
Njesia e Financimeve
Njesia e Mardhenieve me Klientet Korporate
Njeia e Manaxhimit te Rreziqeve
Njesia e Administrates
Njesia e Administrimit te Portofolit te Financimeve
Njesia e Zhvillimit te Produkteve dhe Marketingut
Njesia e Mardhenieve me Klientet SME
Njesia e Perputhshmerise dhe Pastrimit te Parave
Njesia e Sigurise
Njesia Back Office dhe Procesimit te Pagesave
Njesia e Mbledhjes se Hershme te Financimeve
Njesia e Mbledhjes dhe Rikuperimit te Financimeve
Deget dhe Agjensite

2. Shenime per pasqyrat financiare dhe politikat kontabel

1. Vlerësimi i menaxhimit për aftësinë për vazhdimësi të aktivitetit

Në mënyrë që të përmbushte kërkesat e kapitalit, të limitohen risqet nga ekspozimet e mëdha dhe për vazhduar aktivitetin e saj, në vitin 2011, Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve, vendosi të përthithte humbjet e mbartura më 31 dhjetor 2010 dhe të rriste kapitalin e paguar.

Pas injektimit të kapitalit shtesë, Manaxhimi beson që aftësia e Bankës për të vazhduar aktivitetin nuk cënohet. Për këtë arsye, Banka i ka përgatitur te dhenat financiare mbi bazat e vazhdimësisë së biznesit.

2. Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me "Metodologjinë e Raportimit dhe përmbajtjen e raportimit financiar" ("Metodologjia e Raportimit Financiar" ose "MRF") e aprovuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë më 24 dhjetor 2008. MRF është aprovuar për qellime rregullatore, në perputhje me Nenin 47 të Ligjit Nr 9662, të datës 18 dhjetor 2006 "Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë" ("Ligji Bankar").

3. Politikat kryesore kontabile

(a) Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek Shqiptar rrumbullakosur në mijëshen më të afërt, dhe janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përvec aktiveve të marra nga proceset gjyqësore, të cilat janë të matura me vlerën reale.

(b) Arka dhe mjete monetare të ngjashme

Arka dhe mjetet monetare të ngjashme përfshijnë gjendjen e arkës, balancat me Bankën Qëndrore (përvec rezervës së detyrueshme) si dhe balancat me bankat dhe institucionet e tjera financiare me date shlyerje dhe norme fitimi te paracaktuar.

(c) Te drejtat prej aktiviteteve financuese

Financimet dhe të tjera të pagueshme regjistrohen në bilanc pas zbritjes së fondeve rezervë për mbulim humbjesh nga financimet. Financimet dhe të tjera të pagueshme janë të njejta me huatë dhe paradhëniet për klientët.

Fondet rezervë për mbulim humbjesh janë krijuar në përputhje me rregulloren Nr. 62 të Bankës së Shqipërisë "Mbi Administrimin e Rrezikut të Kredisë" (Rregullorja e Re e Kredisë), e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës më 14 shtator 2011,e amenduar. Rregullorja kërkon që Banka të klasifikojë ekspozimet në kategori rreziqesh të meposhtme. Për cdo kategori të rrezikut, aplikohen normat e fondeve rezervë si më poshtë:

LLOJI I HUASË	NORMA E FONDIT
Standarde dhe jo të kthyera në afat	1%
Në ndjekje	5%
Nën standard	Jo me pak se 20%
Të dyshimta	Jo me pak se 50%
Të humbura	Jo me pak se 100%

Shumat për financimet e dhëna raportohen neto, pas zbritjes së fondeve rezervë për aktivitetet financuese që klasifikohen si nënstandard, të dyshimta dhe të humbura. Fondet e krijuara për humbjet e mundshme nga aktivitetet financuese që klasifikohen si standarde dhe në ndjekje, regjistrohen si provigjion statistikor në anën e detyrimeve të bilancit kontabël. Banka nuk përllogarit të ardhura përfinancimet me probleme.

(d) Bono Thesari

Bono Thesari-të mbajtura-deri në maturim

Keto Bono thesari konta*bilizohen me cmimin e blerjes dhe me te ardhuren e përllogaritur për kuponat që do të paguhen. Cdo zbritje apo prim i përfituar* mbi vlerën nominale në momentin e blerjes përllogaritur deri ditën e maturimit dhe pagesës. Këto Bono Thesari konsiderohen si të mbajtura deri në maturim meqënese Banka ka ndërmend t'i mbajë ato në baza të afatgjata deri në maturitet. Provigjionimi kontabilizohet kur ka gjasa të mëdha që Banka nuk i zotëron dot këto letra deri në maturim për shkak të rrethanave të reja, ose në qoftë se ka një risk të dështimit nga lëshuesi i letrës me vlerë.

(e) Investime ne Mudaraba

Investimet ne Mudaraba jane bashkepjesemarrje, ku Banka luan rolin e investitorit me kapital per sipermarresin ('Mudarib') me qellim marrjen pjese ne nje aktivitet investues. Kur shuma e investimit pritet te jete me e ulet se vlera kontabel ne terma afatgjata e investimit, provigjonet nga zhvleresimet njihen si fitim/humbje.

(f) Aktive të qëndrueshme

Aktive të qëndrueshme paraqiten me koston e tyre pasi të jetë zbritur zhvlerësimi i akumuluar, i cili është i përllogaritur në baza lineare mbi jetëgjatesinë e vlerësuar të përdorimit të aktiveve. Jetëgjatësite e vlerësuara, përdorur për periudhën aktuale dhe krahasuese janë si më poshtë:

- Ndërtesa 20 vite
- Automjete 5 vite

- Pajisje zyre 5 vite
- Kompjutera dhe pajisje elektronike 4 vite
- Mobilje dhe pajisje 5 vite
- Aktive te paprekshme 4 vite

Metodat e amortizimit, jetëgjatësia e përdorshme dhe vlerat e mbetura rishikohen në cdo fund të vitit financiar dhe rregullohen në qoftë se është e nevojshme.

Kostot për riparimet në ambientet me qira, janë të përfshira në aktive të tjera si "Shpenzime që amortizohen nëpër vite" dhe janë të amortizueshme për pese vjet.

(g) Aktive të marra përmes proceseve gjyqësore

Aktivet e marra nëpërmjet proceseve gjyqësore përbëhen nga kolateralet e marra nga banka për financimet e humbura. Këto aktive mbahen si pronësi investuese dhe rivlerësohen mbi baza të rregullta me referencë me cmimet e tregut.Vlera kontabël e këtyre aktiveve përafërson vlerën e tyre aktuale të tregut.

(h) Llogaritë e klientëve

Llogaritë e klientëve në princip përfshijnë depozitat e vecanta investuese ku depozituesit udhëzojnë Bankën për të investuar fondet e tyre në investime të vecanta ose me kushte të paracaktuara. Këto depozita investohen nga Banka nën emrin e saj nën kushtet e kontratave specifike Mudareb të nënshkruara me depozituesit. Këto depozita specifike investuese, të cilat janë të klasifikuara brenda llogarive të klientëve, ndajnë fitimin ose humbjen direkte të investimeve të tyre përkatëse në momentin e realizimit, dhe përndryshe nuk marrin pjesë në fitimin ose humbjen e Bankës.

(h) Shpërndarja e fitimit për klientët

Fitimi i Bankës shpërndahet ndërmjet depozituesve dhe aksionerëve të Bankës në përputhje me parimet e Shariatit Islamik duke përdorur metodën kryesore në grup. Depozituesve ju shpërndahet në llogaritë e tyre pjesa që ju takon nga fitimi në përputhje me maturitetet e kontraktuara të investimeve.

(i) Regjistrimi i të ardhurave

Të ardhura nga bankat dhe institucione të tjera financiare

Të ardhurat nga bankat dhe institucionet e tjera financiare regjistrohen mbi bazë përllogaritjeje.

Kontratat e Financimeve

Të ardhurat nga kontratat e Financimeve regjistrohen mbi bazë përllogaritjeje.

Të ardhurat nga tarifat e shërbimit dhe komisionet

Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve dhe komisionet janë ato që përftohen nga shërbimet financiare të ofruara nga Banka duke përfshirë shërbimet e menaxhimit të mjeteve monetare, të ndërmjetësimit si dhe ato si këshilltar investimi. Të ardhurat nga tarifat e shërbimit dhe komisionet regjistrohen kur ofrohet shërbimi përkatës.

(j)Tatimi

Banka e përcakton tatimin në fund të vitit në përputhje me legjislacionin tatimor Shqiptar. Në vitin 2019, tatimi mbi fitimin është 15% mbi të ardhurat e tatueshme. Tatim fitimi i pagueshëm llogaritet duke rregulluar fitimin statutor përpara taksave për disa zëra të caktuar të të ardhurave dhe të shpenzimeve sic kërkohet nga Legjislacioni Shqiptar. Fitimi statutor bazohet në regjistrimet kontabël të mbajtura nga Banka për qellime te Standardeve Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF) dhe mund te ndryshojne në mënyrë thelbësore nga raportimi i pozicionit financiar për qellime rregullatore në përputhje me MRF.

(k) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar me kursin e këmbimit valutor të datës kur është kryer transaksioni. Aktivet dhe pasivet monetare të shprehura në monedha të huaja në datën e bilancit, janë konvertuar në monedhën matëse me kursin e këmbimit të asaj dite. Diferencat që rrjedhin nga këmbimet valutore regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Aktivet dhe pasivet jo-monetare të shprehura në monedha të huaja janë konvertuar në monedhën matëse me kurset e këmbimit valutor të ditës kur janë kryer transaksionet.

Kapitali aksioner është trajtuar si një zë monetar dhe rivlerësohet në përputhje me politikën e sipërpërmendur. Sipas kuadrit rregullator të Bankës së Shqipërisë kapitali në monedhë të huaj duhet të kontabilizohet në bilanc me kursin e ditës kur është kryer transaksioni dhe një zë "Rezervë Rivlerësimi" krijohet në grupin e kapitalit dhe përfaqëson diferencën midis kursit fiks të Bankës së Shqipërisë të fund vitit me kursin historik me të cilin është regjistuar kapitali në monedhë të huaj.

(l) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtuesit të bëjnë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë direkt në aplikimin e politikave kontabile dhe në vlerat e raportuara të aktiveve, pasiveve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Treguesit aktualë mund të ndryshojnë nga ata të parashikuar.

3. Bilanci kontabel dhe zerat jashte bilancit te permbledhura

Bilanci kontabel dhe zerat jashtë bilancit		
AKTIVET	**Shtator 2019**	**Qershor 2019**
VEPRIMET THESARI & NDËRBANKARE	**3,202,644**	**2,659,022**
Arka dhe Banka qëndrore	1,401,172	1,160,167
Bono thesari	0	0
Llogari rrjedhëse në bankat, instituc. Financiare	524,066	446,752
Depozita me bankat, institucionet financiare	702,017	728,172
Hua per Bankat & Institucione financiare	575,389	323,931
VEPRIMET ME KLIENTËT	**5,118,912**	**5,171,600**
Hua standarte për klientët	4,790,830	4,824,131
Hua në ndjekje	257,700	268,872
Hua nënstandart	58,103	69,343
Fonde rezervë për huatë nënstandart	-12,174	-15,453
Hua të dyshimta	49,128	49,606
Fonde rezervë për huatë e dyshimta	-24,676	-24,899
Hua të humbura	104,336	107,236
Fonde rezervë për huatë e humbura	-104,336	-107,237
MJETE DHE DETYRIME TË TJERA	**298,254**	**305,578**
MJETET E PËRHERSHME	**155,044**	**159,279**
Interesa pjesëmarrëse	0	0
Mjete të qëndrueshme	155,044	159,279
TOTALI I AKTIVEVE	**8,774,854**	**8,295,479**

PASIVET	Shtator 2019	Qershor 2019
VEPRIMET E THESARIT & NDËRBANKARE	**777,506**	**736,757**
Llogari rrjedhëse me bankat, institucionet financiare	71,295	29,037
Depozita nga bankat, institucionet financiare	706,197	707,707
Hua marre nga Bankat dhe institucionet e kreditit	13	13
VEPRIMET ME KLIENTËT	**6,559,111**	**6,217,307**
Qeveria Shqiptare & administrata publike	6,333	5,076
Detyrime ndaj klientëve për llogaritë	6,539,676	6,199,254
Llogari rrjedhëse	1,511,707	1,445,374
Llogari depozitash me afat	5,027,969	4,753,881
Llogari të tjera të klientëve	13,102	12,977
DETYRIME TË TJERA	**95,289**	**61,807**
BURIME TË PËRHERSHME	**1,342,949**	**1,279,607**
Fondet rezervë specifike	82,215	81,641
Kapitali i aksionerëve	1,260,734	1,197,967
Kapitali i paguar*	1,762,716	1,762,716
Primet e aksioneve		
Rezerva	159,193	159,193
Diferenca e rivlerësimit	-294,579	-347,285
Fitimi (humbja) i pashpërndarë	-352,720	-352,720
Fitimi (humbja) i vitit ushtrimor	-13,876	-23,938
TOTALI I PASIVEVE	**8,774,854**	**8,295,479**

Shenime:

Gjatë tremujorit të trete 2019, Banka ka nje renie prej 0.05 milion Leke ne aktivitetit financues (450 milion në Tremujorin e dyte 2019) e ndikuar nga renia e nivelit te kredive te reja si edhe nga renia e kursit te kembimit per kete periudhe. Kjo ka sjelle si rezultat nje renie te lehte ne të ardhurat mujore nga financimet. Banka vazhdon te mbaje fondet e lira te investuara ne Institucione Financiare jo rezidente kryesisht per periudha deri ne 3 muaj. Në zërat e pasivit,depozitat e klienteve jane rritur, kryesisht prej llogarive rrjedhese dhe depozitat me afat maturimi mbi nje vit. Gjate kesaj periudhe nuk ka pasur ndonjë shtesë në Kapitalin Aksioner. Në lidhje me rezultatin financiar, impakti negativ vjen nga: rrijta e shpenzimeve per matsercard, nga rritja e shpenizmeve te interesit per depozitat me maturitet me te larte, sidomos 5 vjecar, nga provigjionet e krijuara per investimin IICG si edhe per pronat e marra nga kolateralet.

Bilanci kontabel dhe zerat jashte bilancit te permbledhura (vazhdim)

ZËRAT JASHTË BILANCIT	Shtator 2019	Qershor 2019
ANGAZHIME FINANCIMI	**25,680**	**26,190**
Angazhime të dhëna	25,680	26,190
Angazhime të marra		
GARANCITË	**12,555,142**	**12,467,893**
Garanci të dhëna	28,742	31,819
Garanci të marra	12,526,400	12,436,073
TRANKSAKSIONE NE VALUTE	**0**	**0**
Valutë e blerë me afat	0	0
Valutë e shitur me afat	0	0
TOTALI	**12,580,822**	**12,494,082**

4. Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve

REZULTATI FINANCIAR	3 mujori i mbyllur ne 30/09/2019	3 mujori i mbyllur ne 30/09/2018
Të ardhura nga veprimtari fitimprurese	**214,809**	198,632
Për veprimet me bankat	19,407	26,712
Nga veprimet me klientët	195,402	171,920
Nga veprimet me letrat me vlerë	0	0
Shpenzime per veprimtari fitimpaguese	**-67,211**	-42,356
Për veprimet me bankat	-954	-1,896
Per veprimet me klientët	-66,257	-40,459
Per veprimet me letrat me vlerë	0	0
Total nga veprimtarite fitimprurese dhe fitimpaguese	**147,598**	156,276
Te ardhurat nga komisionet	45,382	43,123
Nga veprimtaria huadhenese	18,861	23,711
Nga sherbimet bankare	26,520	19,412
Shpenzime per komisionet	-1,978	-2,570

Per veprimtarine huadhenese	-287	-1,078
Per sherbimet bankare	-1,690	-1,492
Fitim/Humbja komisionet neto	**43,404**	40,552
Fitim / Humbja neto nga veprimtaria valutore	4,754	2,562
Shpenzime të tjera të veprimtarisë bankare	0	0
Shpenzime për personelin	-88,401	-90,455
Taksa të tjera përveç taksave mbi të ardhurat	-2,372	-2,391
Shpenzime të përgjithshme të veprimtarisë	-90,457	-93,201
Amortizimi I mjeteve të qëndrueshme	-17,100	-17,841
Shpenzime për fonde rezervë për huatë standarde & ndjekje	-29,890	-76,202
Shpenzime fonde rezervë për huatë nenstandarde, dyshimta,humbje	-10,191	-269,300
Rimarrje nga fonde rezerve per huate standarte& ndjekje	25,728	57,651
Rimarrje nga fonde rezerve per huate nenstandarte,dyshimta,humbura	30,851	365,912
Shpenzime te tjera per Fonde Rezerve	-29,161	-29,702
Llogari per t'u arketuar te pambledhshme	0	0
Te ardhura nga veprimet e qirase	3,596	4,009
Të ardhura të tjera të veprimtarisë bankare	-3,037	-1,998
Fitimi neto nga veprimtarite jo te zakonshme	**801**	1,106
Te ardhura jo te zakonshme	1,000	1,106
Shpenzime jo te zakonshme	-199	0
Fitimi para tatimit	-13,876	46,980
Tatimi	0	0
FITIMI NETO	**-23,938**	**46,980**

5. Treguesit e rentabilitetit

Nr	Tregues te rentabilitetit te bankes	Shtator 2019	Qershor 2019	Mars 2019	Dhjetor 2018	Shtator 2018
1	Kthyeshmeria nga aktivet mesatare (ROAA)(Te ardhurat neto / aktivet mesater*100)	-0.22%	-0.57%	-0.76%	0.20%	0.74%
2	Shpenzime te pergjithshme te veprimtarise/ te ardhurat bruto te veprimtarise	96.91%	102.80%	103.46%	97.69%	95.90%
3	Te ardhurat neto nga interesi / shpenzimet e pergjithshme te veprimtarise	58.04%	53.32%	58.16%	66.24%	67.19%

4	Kthyeshmeria nga kapitali aksionar mesatar (ROAE)(te ardhurat neto / kapitali aksionar mesatar*100)	-1.49%	-3.95%	-5.28%	1.39%	4.99%
5	Aktive per punonjes (totali I aktiveve / numri I rregjistruar I punonjesve) ne Lek'000	111,708	111,484	115,611	111,679	109,968
6	Te ardhurat neto nga interesi / aktivet mesatare	2.34%	2.18%	2.26%	2.53%	2.52%
7	Marzhi neto nga interesat	2.92%	2.68%	2.70%	3.02%	3.00%
8	Te ardhurat nga interesat / aktivet mesatare	3.38%	3.19%	3.16%	3.23%	3.19%
9	Shpenzimet per interesa / aktivet mesatare	1.04%	1.02%	0.91%	0.70%	0.67%
10	Te ardhurat neto nga interesat / te ardhurat bruto te veprimtarise	58.31%	58.20%	67.55%	61.52%	53.49%
11	Te ardhurat neto nga veprimtarite e tjera/ aktivet mesatare	0.78%	0.78%	0.59%	0.69%	0.72%
12	Shpenzimet jo per interesa / te ardhurat bruto te veprimtarise	81.29%	89.40%	96.32%	81.10%	72.66%
13	Shpenzime personeli / te ardhurat bruto te veprimtarise	30.12%	33.07%	34.47%	27.95%	26.60%
14	Shpenzime/Rimarrje per provigjone / aktive mesatare	-0.34%	-0.46%	-0.63%	0.11%	0.58%

6. Struktura e Kapiltalit Rregullator

Kapitali rregullator i Bankes ne baze te karakteristikave te tij dhe kushteve te percaktuara ne rregulloren per "Kapitalin rregullator te bankes", ndahet ne dy kategori:

a) kapital i nivelit te pare
b) kapital i nivelit te dyte

a) Kapitali i nivelit I llogaritet si shume e kapitalit baze te nivelit te pare dhe kapitalit shtese te nivelit te pare, duke marre ne konsiderate zbritjet sipas kerkesave rregullatore. Elementet perberes te tij jane:

- kapitali i paguar, i cili perbehet nga aksionet e zakonshme, te cilat mbartin te gjitha karakteristikat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare". Kapitali i paguar perbehet nga aksione te cilat nuk jane preferenciale dhe nuk ka kufizime mbi to.;
- primet e ketyre aksioneve;
- fitimet e pashperndara dhe humbjet e mbartura nga periudhat e meparshme, te cilat perfshihen ne kapitalin rregullator vetem me miratimin e asamblese se pergjithshme per pjesen qe parashikohet te jete element perberes se tij;
- fitimi ushtrimor i fundvitit;
- fitimi ushtrimor i periudhes raportues, i cili perfshihet vetem ne rast se plotesohen kushtet e percaktuara ne rregullore;
- rezervat, te cilat perfshijne rezervat ligjore te krijuara me vendim te asamblese se aksionereve ;
- diferencat e rivlersimit kreditore, te cilat jane diferencat qe lindin nga fakti qe per standartet lokale, kapitali i bankes konvertohet ne LEK me kursin ne periudhen raportuese dhe nuk mbahet me kosto historike.

Si ze zbrites i kapitalit baze te nivelit te pare jane:

- humbjet e periudhes raportuese;
- aktivet e patrupezuara;
- pjesen e shumes se pjesemarrjeve te drejtperdrejta ne instrumentet e kapitalit te nivelit te pare ne Filiale, duke konsideruar si pjese te zbritshme, ate qe tejkalon kufirin prej 10% te kapitalit baze te nivelit te pare para zbritjeve ne fjale.

Në datë 30 Shtator 2019, kapitali i regjistruar eshte 1,762,717 mije Lek i ndarë ne 547,421 aksione me vlere nominale 3,220.04 Lekë ose 24.01USD per aksion. Struktura e kapitalit rregullator përbëhet nga elementët kryesorë të Nivelit të Parë, Kapitali i nivelit të dytëështë zero, pasi Banka nuk ka instrumente të borxhit të varur.

Banka ben llogaritjen e kapitalit rregullator sipas kerkesave te rregullores “Per kapitalin rregullator te bankes”, ne fuqi nga data 31.03.2015.

Zëri	Shtator 2019	Qershor 2019
KAPITALI RREGULLATOR	1,253,872	1,190,730
KAPITAL I NIVELIT TE PARE	1,253,872	1,190,730
KAPITAL BAZE I NIVELIT TE PARE	1,253,872	1,190,730
Instrumenta të kapitalit të njohura si Kapital Bazë i Nivelit të Parë (KBN1)	1,762,717	1,762,717
Kapitali i paguar	1,762,717	1,762,717
Zëra memorandumi: Instrumenta kapitali jo të njohura	0	0
Primet e aksioneve	0	0
(-) Instrumenta të veta të Kapitalit Bazë të Nivelit të Parë	0	0
(-) Detyrime aktuale ose të mundshme për të blerë instrumenta të veta të Kapitalit Bazë të Nivelit të Parë	0	0
Fitimet e pashpërndara	-352,720	-352,720
Fitimet e pashpërndara dhe humbjet e mbartura nga periudhat e mëparshme	-352,720	-352,720

Rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit)	159,193	159,193
Diferenca rivleresimi kreditore	-294,579	-347,285
Rregullime të KBN1 lidhur me filtrat prudencialë	0	0
(-) Emri i mirë	0	0
(-) Aktive të tjera të patrupëzuara	-6,863	-7,237
(-) Shuma bruto e aktiveve të tjera të patrupëzuara	6,863	7,237
(-) Aktivet tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe nuk burojnë nga diferencat e përkohshme, të netuara me detyrimet tatimore të lidhura		
(-) Aktivet e fondeve të pensionit me përfitim të përcaktuar	0	0
(-) Pjesëmarrje reciproke të kryqëzuara në KBN1		
(-) Teprica e zbritjeve nga zërat e Kapitalit Shtesë të Nivelit të Parë që tejkalojnë Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë	0	0
(-) Pjesëmarrjet influencuese (qualifying holdings) jashtë sektorit financiar të cilat (në mënyrë alternative) mund të jenë subjekt i një peshe me rrezik prej 1250%		
(-) Pozicionet e titullzimit të cilat (në mënyrë alternative) mund të jenë subjekt i një peshe me rrezik prej 1250%		
(-) Transaksione jo DVP (free delivery) të cilat (në mënyrë alternative) mund të jenë subjekt i një peshe me rrezik prej 1250%		
(-) Instrumenta të KBN1 të subjekteve të sektorit financiar ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme		
(-) Aktive tatimore të shtyra të zbritshme që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe burojnë nga diferencat e përkohshme		
(-) Instrumenta të KBN1 të subjekteve të sektorit financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme		
(-) Shuma që tejkalon kufirin prej 17.65%		
KAPITALI SHTESE I NIVELIT TE PARE	0	0
Instrumentat e kapitalit të njohura si Kapital Shtesë i Nivelit të Parë	0	0
(-) Instrumentat e veta të Kapitalit Shtesë të Nivelit të Parë	0	0
(-) tepricat e zbritjeve nga zërat e kapitalit të nivelit të dytë (T2) që tejkalojnë kapitalin e nivelit të dytë (T2)	0	0
KAPITALI I NIVELIT TE DYTE	0	0
Instrumentat e kapitalit dhe borxhi i varur të njohur si kapital i nivelit të dytë	0	0
(-) Instrumentat e veta të kapitalit të nivelit të dytë (T2)	0	0
Metoda Standarte (SA) rregullimet kryesore të rrezikut të financimit		

7. Mjaftueshmeria e Kapitalit

Kapitali rregullator duhet ne cdo kohe te mbuloje kerkesen per kapital te nevojshem per mbulimin e rrezikut te fiancimit, te mbulimit te rrezikut te tregut dhe te mbulimit te rrezikut operacional.
Mjaftueshmeria e kapitalit llogaritet si raport ndermjet shumes se kapitalit rregullator me shumen e ekspozimeve te ponderuara me rrezikun, shprehur kjo ne perqindje, ne zbatim te plote te rregulloreve ne fuqi.

Banka llogarit ekspozimet e ponderuara me rrezikun, si shumë e elementëve të mëposhtëm:

a) zërave të ekspozimeve dhe ekspozimeve të mundshme, të ponderuara me rrezikun e financimit dhe rrezikun e kundërpartisë, të llogaritura sipas Metodës Standarde, të përcaktuar respektivisht në kreun III dhe në kreun VI në rregulloren e Bankës së Shqipërisë "Mbi mjaftueshmerine e Kapitalit";
b) kërkesës për kapital për rrezikun e tregut, të llogaritur sipas kërkesave të përcaktuara në kreun VII të rregullores e Bankës së Shqipërisë "Mbi mjaftueshmerine e Kapitalit", të shumëzuara me 12.5;
c) kërkesës për kapital për rrezikun operacional, të llogaritur sipas Metodës së Treguesit të Thjeshtë ose sipas Metodës Standarde, të përcaktuara në kreun VIII të rregullores e Bankës së Shqipërisë "Mbi mjaftueshmerine e Kapitalit", të shumëzuara me 12.5.

Banka e ka zbatuar Metodologjine sipas Rregullores se Keshillit Mbikeqyres te Bankes se Shqiperise per Mjaftueshmerine e Kapitalit, miratuar me Vendimin Nr.48, date 31.07.2013 te Keshillit Mbikeqyres te Bankes se Shqiperise.

Banka e Shqiperise kerkon nga çdo banke apo Grup bankar:

(a) te mbaje nivelin minimal te kapitalit rregullator prej 1 miliard leke

(b) te ruaje nje raport total rregullator me asete te ponderuara me rrezik ne nivelin e pranuar nderkombetarisht prej 12% ose me lart, dhe qe Banka te veproje ne perputhje me keto kerkesa.

Raporti i mjaftueshmërise së kapitalit		Shuma
(në mijë lekë)		
	KAPITALI RREGULLATOR	1,253,872.09
	RMK (%)	18.13
	SHUMA TOTALE E EKSPOZIMEVE TE PONDERUARA ME RREZIK	6,914,474.35
	RREZIKU I Financimit	
1.	**Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rrezikun e financimit, kundërpartisë, dhe rrezikun e shlyerjes së transaksioneve jo-DVP - Metoda Standarde (SA)**	6,469,101.43
1.1	Klasat e ekspozimit sipas SA duke përjashtuar pozicionet e titullzimit	6,469,101.43
1.1.1	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qëndrore ose bankave qëndrore;	0.00
1.1.2	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale;	0.00
1.1.3	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe ndërmarrjeve jo tregtare (organizatat joqeveritare/jofitimprurëse);	0.00
1.1.4	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit;	0.00
1.1.5	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare;	0.00
1.1.6	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura;	551,187.39
1.1.7	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave);	1,004,555.88
1.1.8	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail);	98,016.74
1.1.9	Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme;	4,167,987.06
1.1.10	Ekspozime (financime) me probleme;	74,273.50

1.1.11	Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë;	0.00
1.1.12	Ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara;	0.00
1.1.13	Ekspozime në formën e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive SiK;	0.00
1.1.14	Zëra të tjerë	573,080.86
1.2	Pozicionet e titullzimit SA	**0.00**
1.2*	nga të cilat:rititullzime	**0.00**
	RREZIQET E TREGUT	**0.00**
2.	**Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rreziqet e tregut**	**33,271.28**
2.1	**Shuma e ekspozimit me rrezik për rrezikun e shlyerjes**	**0.00**
2.1.1	Rreziku i shlyerjes në librin e bankës	**0.00**
2.1.2	Rreziku i shlyerjes në librin e tregtueshëm	**0.00**
2.2	**Shuma e ekspozimit me rrezik për rrezikun e pozicionit, kursit të këmbimit dhe mallrave (SA)**	**33,271.28**
2.2.1	Rreziku i pozicionit të titujve të borxhit	**0.00**
2.2.2	Rreziku i pozicionit të instrumentave të kapitalit	**0.00**
2.2.3	Rreziku i kursit të këmbimit	**33,271.28**
2.2.4	Rreziku i investimeve në mallra	**0.00**
2.3	**Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezik për rrezikun e përqendrimit në librin e tregtueshëm**	**0.00**
	RREZIKU OPERACIONAL	
3.	**Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezik për rrezikun operacional**	412,101.64
3.1	**Metoda e Treguesit Bazik (BIA)**	412,101.64
3.2	**Metoda Standarde / Standarde Alternative**	0.00
4.	**Shtesat për rritjen në klasat në "Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimet me letrat me vlerë" të jorezidentëve, në valutë**	0.00
4.1	Totali i zërave të pasivit i "Veprimeve me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimeve me letrat me vlerë" të jorezidentëve, në valutë, mars 2013	0.00
4.2	Totali i zërave të aktivit i "Veprimeve me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimeve me letrat me vlerë", jorezidente në valutë në periudhën raportuese	0.00
4.3	Rritja e zërave të aktivit i "Veprimeve me thesarin dhe transaksioneve ndërbankare" dhe "Veprimeve me letrat me vlerë" të jorezidentëve, në valutë	0.00
4.4	Totali i zërave të pasivit i "Veprimeve me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimeve me letrat me vlerë" të jorezidentëve, në valutë, mars 2013	0.00
4.5	Totali i zërave të pasivit i "Veprimeve me thesarin dhe transaksioneve ndërbankare" dhe "Veprimeve me letrat me vlerë" të jorezidentëve, në valutë, në periudhën raportuese	0.00
4.6	Rritja e zërave të pasivit i "Veprimeve me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimeve me letrat me vlerë" të jorezidentëve, në valutë	0.00
5.	**Pakësimet për rritjen e portofolit të financimit brenda vendit për vitin 2016**	0.00
5.1	Portofoli i financimit bruto, në dhjetor 2015	0.00
5.2	Portofoli i financimit bruto, në periudhën raportuese 2016	0.00

5.3	Rritja e portofolit të financimit, 2016	0.00
5.4	Rritja e portofolit të financimit për 2016-ën që plotëson kushtet për t'u zbritur nga totali i aktiveve të ponderuara me rrezik	0.00
5.4.1	nëse periudha raportuese është mars 2016	0.00
5.4.2	nëse periudha raportuese është qershor, 2016	0.00
5.5	nëse periudha raportuese është shtator 2016	0.00
5.6	nëse periudha raportuese është dhjetor 2016	0.00
5.5	**4% e portofolit të financimit së dhjetorit 2015**	0.00
5.6	**10% e portofolit të financimit së dhjetorit 2015**	0.00
5.7	*Rritja vjetore e portofolit të financimit*	0.00
5.7.1	*nëse periudha raportuese është mars 2016*	0.00
5.7.2	*nëse periudha raportuese është qershor, 2016*	0.00
5.7.3	*nëse periudha raportuese është shtator 2016*	0.00
5.7.4	*nëse periudha raportuese është dhjetor 2016*	0.00

Ekspozimet e ponderuara me rrezikun llogariten si shume e elementeve te meposhtem:
a) zerave te ekspozimeve dhe ekspozimeve te mundshme, te ponderuar me rrezikun e financimit dhe rrezikun e kunderpartise, te llogaritura sipas Metodes Standarte te rregullores se Mjaftueshmerise se Kapitalit.

b) kerkeses per kapital per rrezikun e tregut, te llogaritur sipas kerkesave te rregullores se Mjaftueshmerise se Kapitalit, te shumezuara me 12.5;

c) kerkeses per kapital per rrezikun operacional, te llogaritur sipas Metodes se treguesit te thjeshte, te percaktuar ne rregulloren e Mjaftueshmerise se Kapitalit, te shumezuara me 12.5.

Rreziku I financimit – Informacion I Pergjithshem

8. Klasifikimi I portofolit te financimeve sipas sektoreve

Financim sipas sektoreve të ekonomisë	Financim e re	Shtator 2019
(në mijë lekë)	**Per Tremujorin**	**Teprica Bruto**
Financim afatshkurtër	**294,244**	**1,362,792**
Lekë	**91,904**	**584,258**
Sektori shtetëror	0	0
Sektori privat	91,206	578,974
Individët	698	5,284

Valutë	**202,340**	**778,534**
Sektori shtetëror	0	0
Sektori privat	202,168	777,870
Individët	171	664
Financim afatmesme	**74,013**	**1,308,675**
Lekë	**57,767**	**499,259**
Sektori shtetëror	0	0
Sektori privat	43,677	407,736
Individët	14,090	91,523
Valutë	**16,245**	**809,417**
Sektori shtetëror	0	0
Sektori privat	14,343	763,737
Individët	1,902	45,679
Financim afatgjatë	**138,963**	**2,584,158**
Lekë	**61,633**	**1,191,870**
Sektori shtetëror	0	0
Sektori privat	11,671	506,019
Individët	49,961	685,851
Valutë	**77,331**	**1,392,287**
Sektori shtetëror	0	0
Sektori privat	14,061	783,130
Individët	63,270	609,157
Totali	**507,220**	**5,255,625**

- *Ky raportim eshte vetem per financimet dhene rezidentëve*

9. Klasifikimi i portofolit te financimeve sipas tipit te industrise

Evidenca e financimit sipas degëve të ekonomisë	Financimi ri	Teprica Bruto
në mijë lekë	per tremujorin	Shtator 2019
Degët e ekonomisë		
Bizneset	377,126	3,817,466
Bujqësia, Pyjet, Peshkimi	0	376
Industria nxjerrëse	0	0
Industria përpunuese	0	320,179
Energjia elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	8,023	49,297
Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	0	0

Ndërtimi	31,892	561,808
Tregtia me shumicë dhe me pakicë; Riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	300,525	2,608,414
Transporti dhe magazinimi	0	13,500
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	0	26,061
Informacioni dhe komunikacioni	0	0
Aktivitete financiare dhe të sigurimit	36,686	204,677
Aktivitete të pasurive të paluajtëshme	0	0
Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	0	3,923
Shërbime administrative dhe mbështetëse	0	0
Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshëm	0	0
Arsimi	0	20,529
Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale	0	8,405
Arte, argëtim dhe çlodhje	0	0
Aktivitete të tjera shërbimi	0	297
Aktivitetet të familjeve si punëdhënës; Aktivitete të prodhimit të mallrave e shërbimeve të pandryshueshme të familjeve për përdorimin e vet	0	0
Aktivitete të organizatave dhe organizmave ndërkombëtare	0	0
Individët	130,094	1,438,159
Financimi konsumatore	20,634	303,490
Financim për blerje banesash	109,460	1,134,669
Totali	**507,220**	**5,255,625**

- *Financim dhene rezidenteve*

10.Klasifikimi i portofolit te financimeve sipas shperndarjes gjeografike

QYTETET	Financimet e reja per tremujorin (ne mije lek)	Teprica Bruto – Shtator 2019 (ne mije lek)
Tirane	426,526	3,831,109
Durres	4,484	479,604
Shkoder	63,243	653,563
Fier	49,652	291,349
Total	**543,906**	**5,255,625**

11.Klasifikimi I portofolit bruto sipas maturitetit te mbetur (kontraktual)

	VITE							TOTALI
(në mijë lekë)	DERI 7	7 DITE-1 MUAJ	1-3	3-6	6-12	1-5	> 5	
Veprime me klientet								
Hua Standarte	395,074	231,419	445,366	257,574	670,197	1,846,262	944,939	4,790,830
Hua te pakthyera ne afat	-	-	-	-	-	-	-	-
Hua ne ndjekje	29,236	6,281	7,862	11,540	20,981	138,496	43,303	257,700
Hua nenstandart	-	-	-	-	-	58,103	-	58,103
Hua te dyshimta	-	-	-	-	-	49,128	-	49,128
Hua te humbura	-	-	-	-	-	104,336	-	104,336
TOTALI	**424,310**	**237,701**	**453,227**	**269,114**	**691,178**	**2,196,325**	**988,243**	**5,260,097**

12.Shuma e Financimeve qe u ka kaluar afati dhe atyre me problem sipas sektoreve te ekonomise

Teprica e Financimeve qe u ka kaluar afati - rezidentët sipas degëve të ekonomisë					
(në mijë lekë)	Ne Ndjekje	Nenstandart	Te Dyshimta	Te Humbura	Total
Financim afatshkurtër	**3,751**	**0**	**4,836**	**2,284**	**10,871**
Lekë	**-**	**-**	**1,124**	**2,282**	**3,406**
Sektori privat	-	-	1,124	2,282	**3,406**
Individët	-	-		-	**-**
Valutë	**3,751**	**0**	**3,712**	**2**	**7,465**
Sektori privat	3,751	0	3,712	-	**7,464**
Individët	-	-	-	2	**2**
Financim afatmesme	**41,413**	**18,883**	**5,825**	**82,791**	**148,911**
lekë	**34,538**	**18,883**	**3,692**	**46,700**	**103,813**

Sektori privat	22,595	16,000	1,086	43,933	**83,614**
Individët	11,943	2,883	2,606	2,767	**20,199**
valutë	**6,875**	**-**	**2,132**	**36,091**	**45,098**
Sektori privat	1,226	-	1,139	34,010	**36,376**
Individët	5,649	-	993	2,080	**8,722**
Financim afatgjatë	**212,535**	**39,220**	**38,467**	**19,035**	**309,258**
lekë	**30,954**	**18,261**	**-**	**11,010**	**60,226**
Sektori privat	30,879	13,269	-	5,676	**49,825**
Individët	75	4,992	-	5,334	**10,401**
valutë	**181,581**	**20,960**	**38,467**	**8,025**	**249,032**
Sektori privat	177,317	20,960	15,483	-	**213,759**
Individët	4,264	-	22,984	8,025	**35,273**
Totali	**257,700**	**58,103**	**49,128**	**104,110**	**469,041**
Shpenzime per provigjone	**16,280**	**12,174**	**24,676**	**104,336**	**157,465**

13.Shuma e Financimeve qe u ka kaluar afati dhe atyre me problem sipas degeve

NE '000 LEK

Financimet qe u ka kaluar afati dhe me probleme sipas shperndarjes gjeografike	Ne Ndjekje	Nenstandart	Te Dyshimta	Te Humbura	Total
TIRANE	182,573	56,024	34,452	96,767	369,817
SHKODER	30,679	-	9,343	339	40,361
FIER	44,448	2,079	5,333	5,284	57,144
DURRES	-	-	-	1,945	1,945
Totali	257,700	58,103	49,128	104,336	469,267
Shpenzime per provigjone	16,280	12,174	24,676	104,336	157,465

14.Fondet per provigjione dhe levizjet gjate periudhes

Kodi	FONDET REZERVË TË KRIJUARA NGA BANKA	Teprica në fillim Qtr 3_2019	Shtimi i provigjonev.	Rimarrje e provigjonev.	Financimet e fshira gjatë periudhës	Efekti I kursit te kembimit gjatë periudhës	Teprica në fund Qtr.3_2019
238	FR për mbulimin e humbjeve nga huatë nënstandard	15,453	843	4,101	0	21	12,174
248	FR për mbulimin e humbjeve nga huatë e dyshimta	24,899	669	794	0	98	24,676
258	FR për mbulimin e humbjeve nga huatë e humbura	107,237	1,578	4,567	0	-88	104,336
418	FR per zhvkeresimin e mjeteve te tjera	86,061	7,800	341	0	-411	93,931
518	FR per zhvleresim	6,054	0	0	0	-225	6,279
551	FR për rreziqe e shpenzime	69,341	7,308	8,889	0	-322	68,082
558	FR specifike të tjera	12,300	2,424	644	0	-52	14,133
	Totali	**321,343**	**20,621**	**19,334**	**0**	**-979**	**323,610**

15.Rreziku i Likuiditetit- Informacion i pergjithshem

a. Niveli i burimeve te fondeve nga te tretet sipas maturitetit te mbetur

Treguesi	DITE	MUAJ	VITE					TOTALI
(në mijë lekë)	DERI 7	7 DITE- 1 MUAJ	1-3	3-6	6-12	1-5	> 5	
Veprime me Institucione Financiare	71,295	0	147,443	60,535	91,845	406,387	0	777,505
Llogari rrjedhese te institucioneve Financiare	71,295	0	0	0	12	0	0	71,307
Depozita me afat te institucioneve Financiare	0	0	147,443	60,535	91,833	406,387	0	706,197
Huamarrje nga institucionet Financiare	0	0	0	0	0	0	0	0
Veprime me Klientet	1,592,815	317,628	443,692	1,060,436	1,217,708	1,920,498	0	6,552,777
Llogari Rrjedhese	1,511,707	0	0	0	0	0	0	1,511,707
Depozita me afat	81,108	317,628	443,692	1,060,436	1,210,927	1,914,177	0	5,027,969
Llogari te tjera te klienteve	0	0	0	0	6,781	6,321	0	13,102
Veprime me administraten publike	6,333	0	0	0	0	0	0	6,333
Llogari rrjedhese	6,333	0	0	0	0	0	0	6,333
TOTALI	**1,670,443**	**317,628**	**591,135**	**1,120,971**	**1,309,553**	**2,326,885**	**0**	**7,336,615**

b. Fluksi i rrjedhjes se parase

	Qershor 2019	Qershor 2019
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operative	**Ne '000 lek**	**Ne '000 lek**
Humbja neto e periudhes (para taksave)	(-13,877)	(23,938)
Rregullimet për zërat jo monetarë:		
Zhvlerësimi	17,100	11,394
Zhvlerësimi i rregullimeve të pronave me qira	-	-
Provigjon për humbjet dhe provigjon statistikor	(-16,498)	(8,542)
Provigjon për humbjet nga fondet e investimit & zhvleresime te tjra	38,684	27,836
Ndryshim në diferencën e rivlerësimit për kapitalin	50,997	(1,709)
Të ardhura nga aktive financiare	(-218,244)	(133,450)
Shpenzime për pjesëmarrjen e klientëve	67,211	42,441
	(-74,628)	**(85,970)**
Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operative:		
Pakesim/(rritje) në te drejtat nga aktivitetet financuese	(-499,099)	(523,655)
Pakesim/(rritje) në aktivet e tjera	83,384	86,908
Pakesim/(rritje) në te drejtat ndaj bankave	(-4,381)	(62,225)
Rritje në balancat e klientëve	474,961	81,708
Rritje/(pakësim) në detyrimet e tjera	50,214	15,689
Total	105,080	**(401,576)**
Tatim i parapaguar	0	-
E ardhura financiare e arkëtuar	64,310	153,264
Pagesa për pjesëmarrjen e klientëve	4,870	(30,602)
Para neto gjeneruar /(perdorur) në aktivitete operative	99,632	**(364,884)**
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet investuese		
Para gjeneruar nga blerja e bonove te thesarit	0	-
Blerja e aktiveve fikse neto nga nxjerrja jashte perdorimit	(-17,611)	(19,082)
Change in Investment in Equity	0	-
Para neto (përdorur)/gjeneruar nga aktivitete investuese	(-17,611)	(19,082)
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese		

Rritje e Kapitalit Aksionar	0	-
(Pakesim)/rritje në detyrimet ndaj bankave	(-278,317)	(278,317)
Para neto gjeneruar nga aktivitete financuese	(-278,317)	(278,317)
Rritje neto ne para dhe mjete monetare të ngjashme	(-196,297)	(662,283)
Impakti i kursit te kemibimit ne arke dhe zera te ngjashem	(-19)	1,546
Para dhe mjete monetare të ngjashme në fillim të vitit	2,665,855	2,665,855
Para dhe mjete monetare te ngjashme ne fund te vitit	2,469,540	2,005,118

16.Ekspozimi ndaj risqeve dhe Vleresimi i tyre

1. Rreziku i Financimit

Informacion Cilesor

Banka merr përsipër ekspozimin ndaj rrezikut të financimit i cili është rreziku i humbjes financiare nëse klienti, apo pala e instrumentit financiar, nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga detyrimi. Ky rrezik vjen kryesisht si rezultat i levrimit te financimeve apo transaksione të tjera me palë prej të cilave rrjedhin aktivet financiare. Për qëllime raportimi të administrimit të financimit, Banka konsideron të gjitha elementët e ekspozimit ndaj rrezikut të financimit (si rreziku që rrjedh nga vetë klienti, pozicioni gjeografik dhe sektori).

Administrimi i rrezikut të financimit

Bordi i Drejtorëve ka përgjegjësinë finale për manaxhimin e rrezikut të financimit. Departamenti I Riskut është përgjegjës për monitorimin e rrezikut të financimit së Bankës, ndërkohë qe manaxhimi i rrezikut të financimit përfshin:

- Formulimi i politikave të levrimit te financimeve, mbulimi i përshtatshëm me kollateral, vlerësimi I financimit, shkallëzimi i riskut dhe raportimi, dokumentacioni dhe procedurat ligjore, dhe perputhshmërinë me kërkesat rregullative dhe statutore;
- Themelimin e strukturës autorizuese për aprovimin dhe rinovimin e faciliteteve të financimit. Komiteti i Financimit ose Bordi Drejtues i Bankës ka në dorë kufizimet për sa i përket autorizimeve të ndryshme.
- Mbikëqyrjen dhe vlerësimin e rrezikut të financimit. Komiteti i Financimit të Bankës vlerëson të gjitha ekspozimet ndaj rrezikut të financimit të cilat e kalojnë kufirin e vendosur, përpara se facilitetet të jenë të angazhuara ndaj klientëve. Rinovimet dhe rishikimet e faciliteteve janë subjekt i të njëjtit proçes rishikimi.

- Të kufizojë ekspozimin ndaj palëve, zonave gjeografike dhe industrive (për huatë dhe parapagimet) dhe sipas emetuesit, bandën e klasifikimit të financimeve dhe nivelin e financimit të institucionit financiar, likuiditetin e tregut dhe ndaj shteteve të ndryshme (për investimet).Bordi i drejtuesve ka deleguar përgjegjësinë për adminstrimin e rrezikut tek Komiteti i Financimit të Bankës.
- Zhvillimin dhe përdorimin e sistemit të vlerësimit të rrezikut të Bankës në mënyrë që të kategorizojë ekspozimin në bazë të shkallës së rrezikut të humbjeve financiare, dhe të fokusojë Drejtimin në rreziqet aktuale të Bankës. Sistemi i kategorizimit të rrezikut përdoret për të përcaktuar se kur duhet të krijohen fonde për zhvlerësime të mundshme kundrejt ekspozimeve specifike ndaj rrezikut të financimit.
- Monitorimin e zbatimit të kufijve të aprovuar të ekspozimit nga njësitë e biznesit, duke përfshirë dhe ato për industritë e zgjedhura, rrezikut të vendit dhe llojeve të produkteve.

Çdo njësi biznesi duhet të zbatojë politikat dhe proçedurat e Bankës për administrimin e rrezikut të financimit. Kontrolli i brendshëm kryen në mënyrë të rregullt kontrolle ndaj njësive të biznesit dhe Njësisë të Administrimit të Rrezikut të Financimit.

Banka strukturon nivelet e riskut të financimit që ajo ndërmerr duke vendosur limite në shumën e rrezikut të pranuar në lidhje me një huamarrës, apo grupe huamarrësish, dhe për segmentet gjeografike dhe të industrisë. Kufijtë në nivelin e rrezikut të financimit nga produkti dhe të sektorit të industrisë janë miratuar rregullisht nga drejtimi. Rreziqet të tilla monitorohen mbi baza të përtëritshme dhe janë subjekt i një rishikimi vjetor, apo më të shpeshtë.

Rreziku i financimit për zërat jashtë bilancit përcaktohet si mundësia për mbajtjen e një humbje si rezultat I dështimit i një pale tjetër për një instrument financiar për të kryer në përputhje me kontratën.

Informacion Sasior

Duke filluar nga Mars 2015, perllogaritja e kërkeses për kapital të rrezikut të financimit behet sipas rregullores per "PËR RAPORTIN E MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT", miratuar me vendim nr.8 date 31.07.2013 nga Këshilli Mbikqyrës i Bankës sëShqipërisë, i amenduar.

Tabela me poshte detajon Vlerat e ekspozimeve sipas cilësisë së financimit para dhe pas aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të financimit, si dhe vlerat e ekspozimeve të zbritshme nga kapitalit rregullator, sipas klasave të ekspozimit në bazë të rregullores "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit".

Rreziku I financimit : Informacion per portofolin e financimit sipas metodes standarte , sipas klasave te ekspozimit ne baze te rregullores " Per mjaftueshmerine e Kapitalit"				Ne '000 lek
	Ekspozimi origjinal para faktoreve të konvertimit (neto nga rregullimet e vlerës dhe provigjonet)	Ekspozimi neto pas efektit zëvendësues të teknikave të zbutjes së financimit	Vlera e ekpozimit	Shuma e ekspozimeve të klasifikuara sipas rrezikut
Klasat e ekspozimit				
CR SA - Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore	1,026,616	1,026,616	1,026,616	0
CR SA - Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale	0	0	0	0
CR SA - Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe ndërmarrjeve jo tregtare (organizatat joqeveritare/jofitimprurëse)	0	0	0	0
CR SA - Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit	0	0	0	0

CR SA - Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare	0	0	0	0
CR SA - Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura	1,945,415	1,945,415	1,945,415	551,187
CR SA - Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave)	728,031	728,031	728,031	1,004,556
CR SA - Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail);	123,418	123,418	123,418	98,017
CR SA - Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme	3,982,551	3,982,551	3,982,551	4,167,987
CR SA - Ekspozime (kredi) me probleme	70,382	70,382	70,382	74,273
CR SA - Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë	0	0	0	0
CR SA - Ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara	0	0	0	0
CR SA - Ekspozime në formën e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive SIK	0	0	0	0
CR SA - Zëra të tjerë	824,341	824,341	824,341	573,081
CR SA - Totali i ekspozimeve	**8,700,755**	**8,700,755**	**8,700,755**	**6,469,101**

a. **Teknikat e zbutjes -** Ne portofolin aktual te financimit nuk ka financime qe perfitojne nga teknikat e zbutjes se rrezikut.
b. **Titullizimi-** Banka nuk eshte e ekspozuar ndaj instrumentave qe trajtohen si Titullizim, si rrjedhim nuk perllogarit ekspozime te mundshme.
c. **Ekspozime ne instrumente te Kapitalit-** Banka nuk eshte e ekspozuar ndaj ketyre transaksioneve si rrjedhim nuk perllogarit ndonje rrezik te mundshem

Tabela me poshte jep shperndarjen e ekspozimeve dhe ekspozimeve te mundshme te Bankes sipas klasave te ekspozimeve dhe peshes se rrezikut, kjo e fundit bazuar ne vleresimin e ECAI-ve apo plotesimit te kushteve rregullatore per secilen klase ekspozimi.

Rreziku I financimit : Informacion per portofolin e financimit sipas metodes standarte , sipas klasave te ekspozimit ne baze te rregullores " Per mjaftueshmerine e Kapitalit" (ne Million Leke)											**Pesha e rrezikut**
	Vleresimet nga	**0%**	**10%**	**20%**	**35%**	**50%**	**75%**	**85%**	**100%**	125%	150%
Klasat e ekspozimit											
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore	ECAI	1026									
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale	n/a										
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe ndërmarrjeve jo tregtare (organizatat joqeveritare/jofitimprurëse)	n/a										
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit	n/a										
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare	n/a										
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura	Nuk ka; S&P			1,743					203		

Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave)	n/a								175		553
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail);	Nuk ka						112			11	
Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme	Nuk ka				211	211		113	2556		891
Ekspozime (financim) me probleme	Nuk ka								63		8
Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë	Nuk ka										
Ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara	n/a										
Ekspozime në formën e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive SIK	n/a										
Zëra të tjerë	Nuk ka	375		17					158		274

2. Rreziqet e Tregut - Informacion i pergjithshem

Informacion cilesor

Banka merr përsipër ekspozime të rrezikut të tregut. Rreziqet e tregut lindin nga pozicionet e hapura në : (a) monedha, (b) normat e fitimit dhe (c) produktet e të kapitalit të gjithë të cilat janë të ekspozuar ndaj lëvizjeve të përgjithshme dhe specifike të tregut. Drejtimi vendos limite në vlerën e rrezikut që mund të jenë të pranueshme. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të manaxhojë dhe kontrollojë që ekspozimi ndaj rrezikut të tregut të jetë brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin nga rreziku.

Administrimi i rrezikut të tregut

Autoriteti i përgjithshëm për rrezikun e tregut i është dhënë ALCO-s. Departamenti i Rrezikut të Bankës është përgjegjës për zhvillimin e politikave të detajuara të manaxhimit të rrezikut (subjekt ndaj rishikimit dhe aprovimit nga ALCO dhe Bordi i Drejtorëve) dhe për mbikqyrjen ditore të implementimit të tyre. Banka është e ekspozuar ndaj ndikimeve të ndryshimeve në kurset e këmbimit në pozicionin financiar dhe flukseve të parave.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit për shkak të transaksioneve në monedhë të huaj. Duke qënë se Banka i prezanton pasqyrat e saj financiare të veçanta në Lek, pasqyrat e veçanta financiare të Bankës ndikohen nga lëvizjet e kursit të këmbimit ndërmjet Lek-ut dhe monedhave të tjera. ALCO vendos limitet e niveleve të ekspozimit për të dyja pozicionet; brenda ditës dhe gjatë natës “overnight”, të cilat monitorohen çdo ditë nga Thesari dhe Deparatamenti I Riskut.

Rreziku i valutes se huaj specifikon rrezikun e ndikimeve negative ne rezultatet financiare te bankes dhe mjaftueshmerine e kapitalit te shkaktuar nga ndryshimet ne kurset e kembimit. Banka ka nje nivel te ulet ekspozimi ndaj rrezikut te valutes pasi ajo nuk hyn ne pozicione te hapura valutore spekulative, dhe as nuk angazhohet ne transaksione qe rrjedhin prej tyre. Rreziku i valutes administrohet ne perputhje me Politiken e Administrimit te Rrezikut te Valutes se Huaj dhe rregulloret e Bankes se Shqiperise mbi administrimin e rrezikut te valutes se huaj. Banka monitoron vazhdimisht levizjet e kursit te kembimit dhe tregjet e valutes se huaj dhe menaxhon pozicionet e saj valutore ne baze ditore. Teste stresi kryen rregullisht per te vleresuar ndikimin e levizjeve te kursit te kembimit te pozicionet e hapura valutore (OCP) ne cdo valute.

Informacion Sasior

Duke filluar nga Mars 2015, perllogaritja e kërkeses për kapital të rrezikut të tregut behet sipas rregullores “PËR RAPORTIN E MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT”, miratuar me vendim nr.8 date 31.07.2013 nga Keshilli Mbikqyres i Bankes se Shqiperise,i amenduar.

Mjaftueshmëria e kapitalit për rrezikun e tregut është llogaritur në bazë të Kapitulli VII te rregullores se Bankës së Shqipërisë " Për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit”" , pasi kushtet e mëposhtme nuk plotesohet per fundit e muajit Shtator 2019:

a) Gjatë dy nëntëmujorëve të fundit, raporti i vlerës mesatare kontabël të librit të tregtueshëm ndaj totalit të aktivit nuk është më i lartë se 5%. Në asnjë kohë ky raport nuk është më i lartë se 6%;

b) Gjatë dy nëntëmujorëve të fundit, vlera mesatare kontabël e librit të tregtueshëm nuk është më e lartë se 15 milionë euro. Në asnjë kohë kjo vlerë nuk është më e lartë se 20 milionë euro.

Kërkesa për kapital për rrezikun e tregut është llogaritur si shuma e rrezikut te Pozicionit (Rreziku I Pergjithshem dhe Rreziku Specifik), rrezikut të Përqendrimit ne librin e tregtueshem, Rreziku i Shlyerjes dhe rrezikut të Kursit të Kembimit. Llogaritjet janë bazuar në metoden standarte.

- Rreziku i kursit të këmbimit, perllogaritet ne rastin kur pozicioni total neto i hapur valutor është më e lartë se 2% të kapitalit rregullator. Per fundin e muajit Shtator2019, pozicioni total neto I hapur valutor eshte me e larte se 2% të kapitalit rregullator, rrjedhimisht eshte perllogaritur kerkese per kapital per kete rrezik.

Ne ‘ 000 lek

		Kodi i monedhës	Te gjitha pozicionet		Pozicionet neto		Pozicione me trajtim preferencial		Kërkesa për kapital (%)		Kërkesa për kapital	Ekspozimet e ponderuara me rrezik
MKR SA FX - Rreziku i kursit të këmbimit												
			Në blerje	Në shitje	Në blerje	Në shitje	Në blerje	Në shitje	Në blerje	Në shitje		
		010	020	030	040	050	060	070			090	100
010	Pozicionet totale në monedhë të huaj		11,710	6,014	0	11,710					2,661.70	33,271.28
020	Monedhat me korrelacion të fortë											
030	*Të gjitha monedhat*		11,710	6,014	0	11,710			**8**	**8**	2,661.70	
040	Ari								**8**	**8**	-	

090	Scenario matrix approach											
	Ndarja e pozicioneve sipas llojit të instrumentit											
100	*Instrumenta financiare*		11,710	6,014								
110	*Zëra jashtë bilancit*											
120	*Derivative*											
	Pozicionet në valuta të ndryshme											
130	*Euro*	EUR	11,481	0								
230	*Paundi Britanik*	GBP	207	0								
380	*Dollar Amerikan*	USD	0	6,014								

3. Rreziku i Normes se Fitimit

Informacioni Cilesor

Rreziku i normes se fitimit specifikon rrezikun qe levizjet ne normat e fitimitte tregut do te ndikojne negativisht vleren ekonomike te bankes si dhe fitimet e saj nga fitimi dhe ne fund dhe vete kapitalin. Rreziku i normes se fitimit administrohet ne perputhje me Politiken e Administrimit te Normes se Fitimit dhe udhezuesin e Bankes se Shqiperise mbi administrimin e rrezikut te normes se fitimit ne librin bankar. Gjate vitit 2019 normat e fitimit shfaqen nje tendence renie graduale. Ekspozimi ndaj rrezikut te normes se fitimit matet nepermjet nje analize te hendekut te maturimit. Testet e stresit kryen ne baza vjetore nga Departamenti I Riskut per te matur dhe analizuar ndikimin e ndryshimeve te normave te fitimit ne vleren ekonomike dhe te ardhurat nga fitimet.

Informacioni Sasior

Banka vlereson dhe raporton ndjeshmerine e te gjithe pozicioneve ne librin e bankes ndaj luhatshmerise se normave te fitimit. Per te realizuar kete vleresim banka aplikon nje skenar , i cili supozon nje shock (shift 200 basis point) ndaj kurbes se kthimit, pra supozon nje ndryshim te normave te fitimit prej 200 basis point, në të gjitha monedhat kryesore individualisht, dhe në monedhat të tjera mbi baza të agreguara. Efekti qe rezulton ne ekspozimin e librit te bankes krahasohet kundrejt kapitalit rregullator. Ky raport duhet te jete nen 20% ne menyre qe banka te mos konsiderohet teper e rrezikuar ndaj rrezikut te normave te fitimit.

Burimet/format e rrezikut të normës së fitimit përfshijnë:

a. rrezikun e riçmimit;
b. rrezikun e kurbës së kthimit;
c. rrezikun bazë; dhe
d. rrezikun e opsioneve.

Raporti per administrimin e rrezikut te normës së fitimit ne librin te bankes mbulon te gjithe pozicionet e Librit te Bankes te ndjeshme ndaj normave te fitimit.

Raporti fokusohet ne monedhat kryesore (konsiderohen te tilla nese perbejne mbi 5% te aktiveve totale): ALL, EUR, USD dhe të tjerët. Pozicionet janë të ndarë sipas llojit të produktit dhe llojit te normës (norme fikse kundrejt normes se ndryshueshme). Pozicionet shperndahen ne intervalet kohore perkatese si me poshte:

- Pozicionet me norme fikse janë caktuar ne intervalin kohor sipas maturimit të tyre
- Pozicionet me norme te ndryshueshme jane caktuar sipas datës se ardhshme te rishikimit te normes se fitimit.
- Llogaritë rrjedhëse dhe depozitat pa afat, në pasiv të bilancit, shperndahen sipas mënyrës së përcaktuar më poshtë:
    a. në intervalin kohor “at sight” (menjëherë/pa afat) vendoset një përqindje fikse (25%) e llogarive rrjedhëse dhe depozitave pa afat;
    b. në intervalet kohore nga “deri në 1 muaj” në “4-5 vjet” vendosen në mënyrë proporcionale me numrin e muajve që përmban intervali, llogaritë e mbetura (75%) e atyre të përfshira në shkronjën “”a” më sipër;
- Rezerva e detyrueshme në lekë pranë Bankës së Shqipërisë caktohen në zonën kohore “deri në 1 muaj”, ndërsa rezerva e detyrueshme në monedhë të huaj konsiderohet si pozicion jo i ndjeshëm ndaj rrezikut të normës së fitimit
- Financimet me probleme caktohen në intervalin kohor “2-3 vjet”

Raporti per administrimin e rrezikut te normes se fitimit ne librin e bankes perllogaritet me frekuence mujore nga Departamenti I Riskut ndërkohë që raportimi prane Bankes se Shqiperise performohet në baza tremujore.

Forma totale e IRRBB-s		**Totali i pozicioneve të ponderuara**	
	IRRB	**Monedha**	**Shuma**
		1	**2**
1.1.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHES - (FIR+VIR) - monedha 1	ALL	-85,419
1.2.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHES - (FIR+VIR) - monedha 2	USD	14,834
1.3.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHES - (FIR+VIR) - monedha 3	EURO	10,167
1.4	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHES - (FIR+VIR) - monedha 4	GBP	(713.78)
2	NDRYSHIMI NE VLEREN E EKSPOZIMIT		61,132
3	KAPITALI RREGULLATOR (own funds)		1,253,872
4	**(NDRYSHIMI NE VLEREN E EKSPOZIMIT / KAPITALI RREGULLATOR) * 100**		**4.88%**

4. Rreziku Operacional

Informacion Cilesor

Rrezik operacional është mundësia që subjekti të pësojë humbje financiare si rezultat i papërshtatshmërisë ose dështimit të proceseve të brendshme dhe të sistemeve, gabimeve njerëzore, ose i ngjarjeve të jashtme. Rreziku operacional përfshin dhe rrezikun ligjor, por përjashton rrezikun reputacional dhe strategjik. Politika e rrezikut operacional e bankes eshte ne perputhje te plote me rregulloret e Bankes se Shqiperise per administrimin e rrezikut operacional, me Politiken dhe Proceduren e Rrezikut Operacional, si dhe me Politiken per Parandalimin e Mashtrimit. Per te minimizuar rrezikun operacional dhe rrezikun e mashtrimit, te gjitha proceset dokumentohen me saktesi dhe u nenshtrohen mekanizmave efikase te kontrollit. Pershkrimet e punes jane te plota, detyrat jane te ndara ne menyre strikte dhe eshte shmangur varesia nga individe kyç.

Çeshtjet e rrezikut operacional monitorohen nga Departamenti I Riskut, i cili ka per qellim te percaktoje politika per rreziqet qe lidhen me njerezit, rreziqet qe lidhen me proceset, rreziqet qe lidhen me teknologjine e informacionit dhe sistemet, rreziqet e jashtme dhe aspekte te tjera te rrezikut operacional.

Punonjesve u kerkohet qe te raportojne te gjitha ngjarjet qe perfaqesojne nje humbje faktike apo te mundshme. Ngjarje te raportuara qe permbajne rreziqet me te shtrira, dhe qe konsiderohen si ngjarjet me me shume gjasa per t'u perseritur, i nenshtrohen nje analize te thelle nga Departamenti I Riskut dhe me pas komitetit te ALCOs, i cili me vone propozon masat e pershtatshme parandaluese.

Nje aspekt kyç i administrimit te rrezikut eshte kultura e rrezikut te institucionit, e cila u perçohet te gjithe punonjesve permes trajnimeve sistematike. Rreziqet operative lindin si pasojë e të gjithë operacioneve të Bankës dhe shqyrtohen nga të gjitha njësitë e biznesit. Objektivi i Bankës është të manaxhojë rrezikun operacional në mënyrë që të balancojë shmangien e humbjeve financiare dhe dëmtimin e reputacionit të Bankës me kosto efektive, si edhe të shmangë proçedurat e kontrollit të cilat kufizojnë iniciativën dhe kreativitetin. Përgjegjësia parësore për zhvillimin dhe implementimin e kontrolleve për të adresuar rrezikun operacional i caktohet çdo njësie biznesi. Kjo përgjegjësi mbështetet nga zhvillimi i standardeve të përgjithshme të Bankës për manaxhimin e rrezikut operacional.

Pajtimi me standardet e Bankës mbështetet nga një program kontrollesh periodike të ndërmarra nga Kontrolli i Brendshëm.

Informacion Sasior

Duke filluar nga Mars 2015, perllogaritja e kërkeses për kapital të rrezikut operacional behet sipas rregullores per "PËR RAPORTIN E MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT", miratuar me vendim nr.8 date 31.07.2013 nga Këshilli Mbikqyrës i Bankës sëShqipërisë,e amenduar.

Banka llogarit kërkesën për kapital për rrezikun operacional, sipas metodës së treguesit të thjeshtë, e cila konsideron të ardhurën neto nga veprimtaria bankare për tre vitet e fundit të veprimtarisë së bankës dhe një koeficient α prej 15%.

Treguesi i të ardhurës neto nga veprimtaria bankare për çdo vit, llogaritet si shumë e të ardhurave neto nga fitimi dhe të ardhurave neto jo nga fitimi për atë vit.

Treguesi i të ardhurës neto nga veprimtaria bankare për çdo vit, llogaritet në bazë të të dhënave 12-mujore të vitit fiskal dhe, në rastet kur nuk janë ende të disponueshme të dhënat e kontrolluara (audituara), përdoren vlerësimet e vetë bankës për këtë tregues.

Në llogaritjen e mesatares së tre viteve, nuk do të konsiderohet treguesi i të ardhurës neto nga veprimtaria bankare, nëse në ndonjë prej viteve, ky tregues rezulton negativ ose i barabartë me zero.

Treguesi mesatar i të ardhurës neto nga veprimtaria bankare do të llogaritet si shuma e vlerave pozitive të treguesve të të ardhurës neto nga veprimtaria bankare, pjesëtuar me numrin e viteve, në të cilat treguesi është pozitiv.
Aktivet e ponderuara me risk perllogariten duke shumezuar kerkesen per kapital me nje koeficient prej 12.5.
Perllogaritja e rrezikut operacional behet me baza vjetore ndersa raportimi behet me baza tremujore.

Aktiviteti bankar		Treguesi			Financimi dhe paradhënie (Në rast të aplikimit të metodës standarte të avancuar)			Kërkesa për kapital	Ekspozimet e ponderuara me rrezik
		VITI-3	VITI-2	VITI I FUNDIT	VITI-3	VITI-2	VITI I FUNDIT		
		010	020	030	040	050	060	070	071
010	**1. TOTALI I AKTIVITETEVE BANKARE SUBJEKT I METODËS SË TREGUESIT BAZIK (BIA)**	227,046	248,071	271,861	0	0	0	37,349	466,862
020	**2. TOTALI I AKTIVITETEVE BANKARE SUBJEKT I METODAVE STANDARTE (STA) / STANDARTE ALTERNATIVE (ASA)**								0
	Subjekt i metodës standarte:								
030	FINANCAT E KORPORATAVE (CF)								
040	TREGTIMI DHE SHITJET (TS)								
050	Broker me Pakice (RBr)								
060	BANKINGU TREGTAR(CB)								
070	BANKINGU ME PAKICË (RB)								
080	PAGESAT DHE SHLYERJET (PS)								
090	SHËRBIMET E AGJENCISË (AS)								
100	MENAXHIMI I ASETEVE (AM)								
	Subjekt i metodës standarte të avancuar:								
110	BANKINGU TREGTAR (CB)								
120	BANKINGU ME PAKICE (RB)								
130	**Përqasja AMA**								

5. Rreziku i Likuiditetit

Informacion cilesor

Rreziku i likuiditetit afatshkurter specifikon rrezikun qe banka nuk do te jete me ne gjendje te permbushe plotesisht ose pjeserisht detyrimet e saj aktuale dhe te ardhshme te pagesave. Prandaj, banka duhet te ruaje gjithmone fonde te mjaftueshme likuiditeti per te permbushur detyrimet e saj, madje edhe ne periudhe stresi.

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Banka nuk do të jetë në gjendje të shlyejë detyrimet e saj financiare në kohën e duhur. Banka është e ekspozuar në kërkesa ditore nga burimet e sa j të disponueshme të parasë nga depozitat një ditore, llogaritë rrjedhëse, depozitat e maturuara, shtesat e financimeve, garancitë dhe kërkesa të tjera për shlyerje në para të instrumentave derivateve.
Per te percaktuar fuqine e likuiditetit te bankes perballe nje shoku te mundshem, banka kryen teste stresi te rregullta bazuar ne skenare te percaktuar si standard ne nivel banke.

Administrimi i rrezikut të likuiditetit
Qëndrimi i Bankës në administrimin e likuiditetit është të sigurojë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet si në kushte normale ashtu edhe në kushte të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo të rrezikojë të dëmtojë emrin e saj.
Departamenti i Thesarit merr informacion nga njësitë e tjera për sa i përket rrezikut të aktiveve dhe detyrimeve financiare dhe rrjedhjeve të ardhshme të parave, që rezultojnë nga aktivitetet e ardhshme të projektuara. Në bazë të ketij informacioni, Departamenti i Thesarit mban një portofol me aktive afatshkurtra likuide, i përbërë kryesisht nga investime me afat të shkurtër, hua dhe paradhënie ndaj bankave të tjera, dhe facilitete të tjera ndërbankare, për të siguruar një nivel të mjaftueshëm likuiditeti të Bankës. Kërkesat e njësive të biznesit për likuiditet plotësohen nga Departamenti i Thesarit, i cili jep hua afat-shkurtra dhe afat-gjata për të mbuluar ndryshimet afat-shkurtra dhe për financimet afat-gjata. Pozicioni ditor i likuiditetit monitorohet dhe testohet në mënyrë të rregullt nga Departamenti i Riskut.
Të gjitha politikat dhe proçedurat janë subjekt i rishikimeve dhe aprovimeve nga Bordi Drejtues dhe ALCO.

Informacioni Sasior
Ne perputhje te plote me rregulloren e Bankes se Shqiperise “Per administrimin e rrezikut te likuiditetit” Banka perllogarit, monitoron dhe raporton me baza ditore rapotin qe shpreh nivelin e aktiveve likuide perkundrejt pasiveve afatshkurtra, te njohur ndryshe edhe si raporti i “Treguesve te Likuiditetit”. Referuar rregullores, si zera aktuale likuide dhe shume likuide ne perllogaritjen jane konsideruar zerat e aktivit si me poshte :

a. Arka;
b. llogaritë me Bankën e Shqipërisë, duke përfshirë rezervën e detyrueshme deri në masën e lejuar të përdorimit të saj, të përcaktuar me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë;
c. bonot e thesarit të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, të regjistruara në bilanc si “të tregtueshme“/“të vendosjes“;
d. 80 (tetëdhjetë) për qind të obligacioneve të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të regjistruara në bilanc si “të tregtueshme“/“të vendosjes“;
e. tituj “të investimit“ të Qeverisë Shqiptare (bono thesari dhe obligacione) me maturim të mbetur deri në 1 (një) muaj;
f. 80 (tetëdhjetë) për qind të titujve të qeverisë shqiptare (bono thesari dhe obligacione), që nuk bëjnë pjesë në shkronjat “c“, “d“ dhe “e“, të kësaj dispozite, por që plotësojnë kriteret e rregulloreve të Bankës së Shqipërisë “Mbi garancitë në operacionet kredituese të Bankës së Shqipërisë“ dhe „Mbi

marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes“;

g. llogaritë rrjedhëse në bankat dhe institucionet e tjera financiare;
h. depozita me bankat dhe institucionet e tjera financiare me maturim të mbetur deri në 7 (shtatë) ditë;
i. hua për bankat dhe institucionet e tjera financiare me maturim të mbetur deri në 7 (shtatë) ditë (përjashtohet llogaria 157 ”hua të pakthyera në afat ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare”);

Te gjitha aktivet e mesiperme jane konsiduar te tilla duke qene se mbi to nuk ekziston ansje angazhim/marreveshje qe e detyron banken te mos i perdori ato lirisht dhe ne menyre te pavaruar sa here qe mund te lind nevoja per likuiditet.
Raporti bashkelidhur shpreh nje situate shume te kenaqshme likuiditeti jo vetem ne monedhen kombetare por edhe per monedhat e huaja.

	AKTIVET LIKUIDE - PASIVET AFATSHKURTRA					
Kodi		LEKË	USD	EUR	TË TJERA	TOTALI
	(në mijë lekë)					
1	Arka	115,761	73,175	164,937	20,682	374,555
2	Llogaritë me Bankën e Shqipërisë, duke përfshirë rezervën e detyrueshme deri në masen e lejuar te perdorimit te saj, te percaktuar me akt nenligjor te Bankes se Shqiperise	494,796	24,519	231	0	519,546
3	Letra me vlerë “të investimit“ të Qeverisë Shqiptare (bono thesari dhe obligacione) me maturim të mbetur deri në 1 (një) muaj					
4	80 për qind të letrave me vlerë të qeverisë shqiptare (bono thesari dhe obligacione), që nuk bëjnë pjesë në kodin “3“, “4“ dhe “5“, por që plotësojnë kriteret e rregulloreve të Bankës së SHqipërisë “Mbi garancitë në operacionet kredituese të Bankës së Shqipërisë“ dhe ‘Mbi marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes“					
5	Llogaritë rrjedhëse në bankat dhe institucionet e tjera financiare	8,371	115,420	313,259	699	437,748
6	Depozita me bankat dhe institucionet e tjera financiare me maturim të mbetur deri në 7 (shtatë) ditë	0	67020	0	0	67,020
7	Hua për bankat dhe institucionet e tjera financiare me maturim të mbetur deri në shtatë ditë (përjashtohet llogaria 157 ”hua të pakthyera në afat ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare”);	520,000	0	0	0	520,000
A	**TOTALI I AKTIVEVE LIKUIDE**	**1,138,928**	**280,134**	**478,427**	**21,380**	**1,918,870**
		-	-	-	-	0
B	**TOTALI I PASIVEVE AFATSHKURTRA ME AFAT TË MBETUR MATURIMI DERI NË 1 VIT**	**2,103,426**	**463,271**	**2,449,008**	**21,566**	**5,037,271**
C	**TREGUESI I LIKUJDITETIT (në %)**					
1	Aktive likuide / pasive afatshkurtra * 100 (per monedhen kombetare LEK)					**54.15%**
2	Aktive likuide / pasive afatshkurtra * 100 (per monedhat e huaja)					**26.58%**
3	Aktive likuide / pasive afatshkurtra * 100 (ne total)					**38.09%**